

## GJYKATA SUPREME

Lënda numër:

PML-KZZ 106/2017

(P. no. 98/14 Gjykata Themelore e Mitrovicës)  
(PAKR no. 299/16 Gjykata e Apelit)

Data: 24 Maj 2017

Gjykata Supreme e Kosovës, në Kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Jorge Martins Ribeiro (gjyqtar kryesues dhe raportues), Gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova dhe Gjyqtarja e Gjykatës Supreme të Kosovës, Nesrine Lushta, si anëtarë të Kolegjit, të ndihmuar nga Këshilltarja Ligjore e EULEX-it Vjollca Kroci-Gerxhaliu, në lëndën penale kundër:

**O.I.**, nën masën kufizuese të parapara me Nenin 177 të Kodit të Procedurës Penale, më tej KPP (ndalesë ndaj afrimit të personave të caktuara apo vendeve të caktuara) dhe 178 KPP - së (lajmerim në stacionin policor) me dokumentet e tij të udhëtimit të marra nga gjykata, dhe

*I akuzuar* me Aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS 04/2013, të datës 8 Gusht 2014, dhe të parashtruar në Gjykatën Themelore më 11 Gusht 2014, dhe sa i përket kësaj kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ai ka qenë i akuzuar me

(Akuza një)

**1) Krime Lufte Kundër Popullatës Civile** në shkelje të rëndë të Nenit 3 § 1(a) i Përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 Gusht 1949, që ndërlidhen me Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Lufte, dhe Nenit 4 § 2(a) të Protokollit të II-të Shtesë që ndërlidhet me mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura

të Karakterit Jo-Ndërkombëtar të datës 8 Qershor 1977, sipas Nenit 152 § 1 dhe 2.1 në ndërlidhje me Nenet 16 dhe 32 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPK) dhe gjithashtu e dënueshme në kohën e kryerjes së veprës penale me Nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste federative të Jugosllavisë, të datës 28 Shtator 1976 (KPRSFJ);

*I dënuar nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. no. 98/14, i datës 30 Mars 2016, siç vijon:*

**O.I.** është shpallur fajtor për **Akuzën 1**, për veprën penale të **Krime lufte kundër popullatës civile** e dënueshme me Nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste federative të Jugosllavisë (KPRSFJ) dhe në shkelje të Nenit 3 § 1 (a) i Përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 Gusht 1949 që ndërlidhen me Mbrojtjen e Personave Civile në Kohë Lufte, dhe Nenit 4 § 2 (a) të Protokollit të II-të Shtesë që ndërlidhet me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura të Karakterit Jo-Ndërkombëtar të datës 8 Qershor 1977.

I pandehuri **O.I.** është dënuar me 9 vjet burg. Ai gjithashtu është urdhëruar ta rimbursion shumën prej 750 Eurosh si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale.

Më **Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit** të datës 19 Dhjetor 2016, duke gjykuar për ankesat e parashtruara nga Prokuroria dhe nga i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës, Gjykata e Apelit (PAKR 299/16), i aprovoi pjesërisht ankesat e mbrojtjes, e refuzoi ankesën e Prokurorisë si të pabazuar, dhe rrjedhimisht, aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës është anuluar në lidhje me akuzën një dhe rasti është kthyer në rigjykim për këtë akuzë; aktgjykimi është konfirmuar sa i përket akuzave dy dhe tre.

*Duke vepruar me Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë KMLP/I no. 17/2017 (në tekstin e mëtejshëm: Kërkesa) sa i përket Aktgjyimit të Gjykatës së Apelit PAKR 299/16, të datës 19 Dhjetor 2016, në lidhje me akuzën një, të parashtruar nga Prokurori Shtetëror më 11 Prill 2017 dhe*

të pranuar në Gjykatë Supreme përmes Gjykatës Themelore të Mitrovicës, më 28 Prill 2017;

*Pas marrjes në konsideratë të Përgjigjes së avokatit mbrojtës, të datës 27 Prill 2017, ndaj Kërkesës së Prokurorit Shtetëror për akuzën një Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 299/16, të datës 19 Dhjetor 2016;*

*Pas diskutimit dhe votimit më 24 Maj 2017;*

*Sipas Nenit 418 dhe Neneve 432 deri 441 të Kodit të Procedurës penale (KPP);*

*Nxjerrë këtë:*

## **AKTVENDIM**

Gjykata Supreme e hedh poshtë Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR 299/16, të datës 19 Dhjetor 2016, në lidhje me akuzën një, pasi që ajo është e papranueshme sipas Nenit 435, paragrafit 2 të KPP-së në ndërlidhje me Nenin 432, paragrafin 1 të KPP-së, të lexuara së bashku me Nenin 418, paragrafin 3 të KPP-së, pasi që kërkesa është, për më shumë, e hershme pasi që lënda nuk ka vendim të formës së prerë dhe as që është kryer procedura në formë të prerë.

## **ARSYETIMI**

### **Historia Relevante Procedurale**

**1** – Akuza e lartpërmendur fillimisht është gjykuar në lëndën penale P. no. 98/2014 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës. Me Aktgjykimin e nxjerrë më 21 Janar 2016, i Pandehuri është shpallur fajtor për veprën e cekur penale dhe është dënuar me 9 (nëntë) vjet burg.

**2** – Pas ankesave të dyja palëve, Prokurorisë dhe të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës, më 19 Dhjetor 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PAKR 299/16. Me këtë Aktgjykim, ankesa e mbrojtjes u aprovua pjesërisht, ankesa e Prokurorisë u refuzua si e pabazuar, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës P. no. 98/2014 u anulua sa i përket akuzës 1 dhe lënda është kthyer në rigjykim për këtë akuzë, në Gjykatën Themelore të Mitrovicës.

**3** – Më 11 Prill 2017, Prokurori Shtetëror e parashtri këtë Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë KMLP/I no. 17/2017 kundër Aktgjykimit të cekur të Gjykatës së Apelit, në lidhje me gjykimin për akuzën një, sa i përket, me pak fjalë, dërgimit të lëndës në rigjykim në vend që vet ta ndryshojë vetë gjendjen faktike, sipas Nenit 403 të KPP-së.

**4** – Gjykata Themelore e Mitrovicës ia ka dorëzuar Kërkesën Mbrojtjes më 13 Prill 2017 dhe mbrojtja e parashtri përgjigjen e saj më 27 Prill (e vulosur më 28) 2017.

**5** – Kërkesa i është transferuar Gjykatës Supreme më 28 Prill 2017.

**6** – Në këtë rast, pas hyrjes në fuqi të Ligjit 05/L-103, nuk është e nevojshme që prapë të pyetet KGJK, duke u bazuar në Nenin 3, paragrafin 5 të Ligjit të cekur, për leje për ta formuar kolegjin nga shumica prej gjyqtarëve të EULEX-it me një Gjyqtar të EULEX-it si kryesues, për shkak se kërkesa e mëparshme (më 22/8/2016 PEJ (0107-0001) për një gjë të tillë gjatë tërë rrjedhës së procedurës, është aprovuar më 27 Shtator 2016 (KGJK 1123/2016). Sa i përket vendimit të cekur të KGJK-së, vlen të përmendet se askund nuk është përmendur mbrojtja e ligjshmërisë. Megjithatë, ai fillon me aprovimin e kërkesës së EULEX-it (dhe ajo përbënte gjithashtu edhe kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë) dhe në arsyetim të vendimit nuk ka asgjë në kuptimin që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të përjashtuara).

## **Parashtrësit e Palëve**

### **Parashtrësia e Prokurorit Shtetëror**

Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit sa i përket akuzës 1

Prokurori Shtetëror i kundërshton të gjeturat e Gjykatës së Apelit në Aktgjykimin e vet, sipas të cilit, pika 1 e akuzës kundër **O.I.** duhet të kthehet në rigjykim për shkak të faktit që dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është në kundërshtim me vetveten dhe me pjesën e arsyetimit të Aktgjykimit.

Ai kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës që të shpallë që Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR 299/16 i ka shkelur dispozitat e Nenit 384 (1.12) në ndërlidhje me Nenin 370 (7) të KPP-së, për shkak se ka dështuar ti deklarojë qartë arsyet nga të cilat është udhëzuar në caktimin e pikave të lartpërmendura të ligjit; i ka shkelur dispozitat e Nenit 5 (1) dhe (2) të KPP-së, Nenit 402 dhe 403 të KPP-së sikurse edhe Nenit 22 (2) të Kushtetutës; e ka shkelur Nenin 6 (1) të GJEDNJ (*ECHR*) për shkak se e ka kthyer lëndën në rigjykim në vend që ta modifikonte dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës (ku, sipas Prokurorisë, “Kolegji i Ankesave e ka kuptuar qartë nga arsyetimi i Aktgjykimit, qëllimin e gjykatës së shkallës së parë për ta dënuar **z. I.** për bashkëkryerje”, kjo për shkak se “vetëm në rast se dispozitivi mbetet i pakuptueshëm apo jo-konsistent pasi të jetë lexuar në lidhje me deklaratën mbi arsyet, mund të shpallet e paligjshme dhe aktgjykimi të anulohet”), dhe për shkak se gjykata e ka vlerësuar dhe procesuar gabimisht çështjet që ndërlidhen me situatën faktike (pasi që “Kolegji i Apelit në vend të kësaj ka qenë dashur ta zbatoj Nenin 403 të KPP-së dhe ta rregulloj dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë që të korrespondojë me arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë”, gjithashtu për shkak se “Neni 403 i KPP-së është dizajnuar për ti shmangur rigjykimet nëse gjykata e apelit është në gjendje ti përmirësoj gabimet e aktgjykimit të shkallës së parë”).

### **Përgjigja e avokatit mbrojtës për akuzën një të kërkesës së Prokurorit**

Avokati mbrojtës, në përgjigjen e tij i kërkon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta hedh poshtë Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori Shtetëror, si të papranueshme sipas Nenit 435 (2) të KPP-së, mbi tri baza:

- a) Nuk është parashtruar nga personin i autorizuar pasi që Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë mund të parashtrohet vetëm nga Kryeprokurori Shtetëror i Republikës së Kosovës dhe jo nga Prokurori Special i Kosovës (sipas Nenit 433, paragrafit 1 të KPP-së);
- b) Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë mund të parashtrohet vetëm kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, apo si rezultat i shkeljes së procedurës gjyqësore që ka pasuar me nxjerrjen e atij vendimi, pasi që procedura të jetë përfunduar në formë të prerë; dhe
- c) Kërkesa, nëse pranohet, është e pabazë, pasi që Gjykata e Apelit nuk i ka shkelur Nenet 402 dhe 403 të KPK-së.

### **Kompetenca dhe përbërja e kolegjit**

Gjykata Supreme e Kosovës është gjykatë kompetente për të gjykuar pas ushtrimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, sipas Nenit 418 *et seq.* të KPP-së.

Në përputhje me Ligjin për Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë – Ligji nr. 03/L-053 siç është ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe 05/L-103, lënda konsiderohet si “lëndë në zhvillim e sipër” dhe rrjedhimisht bie nën juridiksionin dhe kompetencën e gjyqtarëve të EULEX-it, në përputhje me Nenin 1, paragrafin 1 dhe 2, dhe Nenin 3, paragrafin 5 të Ligjit 05/L-103 në formulimin e tij aktual.

Përbërja e kolegjit me shumicë nga gjyqtarët e EULEX-it, kryesuar nga një Gjyqtar i EULEX-it, në këtë lëndë është e bazuar në Vendimin Nr. KGJK 1123/2013 të KGJK-së, të datës 27 Shtator 2016, siç përmendet më lartë.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

Kërkesa në këtë lëndë në zhvillim e sipër të EULEX-it, është parashtruar nga një Prokuror nga Zyra e Prokurorit Shtetëror (siç shkruan në vulën e kaltër “Prokuroria e Shtetit”) dhe, thënë me pak fjalë, Kryeprokurori i Shtetit siç ceket në Nenin 433 të KPP-së, nuk është entitet kompetent në këtë rast për ta parashtruar atë sipas Nenit 12 të Ligjit për Prokurorinë e Shtetit 05/L-034, të datës 28 Maj 2015, që i shtoi Nenin 32A ligjit të mëparshëm, 03/L-225 nga Shtatori i vitit 2010; sipas paragrafit 1 të Nenit të cekur 32A, “gjatë kohëzgjatjes së mandatit të misionit të EULEX-it në Kosovë, Kryeprokurori Shtetëror nuk mund ta marrë juridiksionin mbi lëndët e caktuara një Prokurori të EULEX-it, pa pajtimin e Kryeprokurorit të EULEX-it”. Është thënë, “me pak fjalë”, për aq sa mund të thuhet, domethënë, kodi i ri i procedurës penale është në fuqi që prej datës 1/1/2013...dhe e ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme *locus standi* në lidhje me parashtrimin e mbrojtjeve të ligjshmërisë, pasi që në Kodit e Përkohshëm të Procedurës Penale, çdo prokuror publik ka mundur ta bëjë atë (sipas Nenit 452, lexuar së bashku me Nenin 46 *et seq* për kompetencat dhe Nenin 151 për definicionet), por me Kodin e ri të Procedurës Penale ceket vetëm Kryeprokurori Shtetëror (Neni443 dhe Neni 46 për kompetenca i referohet Ligjit për Prokurorinë e Shtetit, Kapitulli IV).

Pas adresimit të çështjes në është i autorizuar ta bëjë këtë ai që parashtror kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, sipas Nenit 433 të KPP-së, është koha për vlerësim se a ekziston baza ligjore për ta parashtruar atë. Bazat janë të caktuara me Nenin 432 dhe Nenin 433, paragrafi 4 të KPP-së. Sipas Nenit 418, paragrafit 3, një palë mund të kërkoj mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre muajve nga aktgjykimi i formës së prerë apo aktvendimi i formës së prerë kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë. Formulimi është i qartë, por duke marrë parasysh futjen sistematike të normës në kod, klasifikimi i mjeteve juridike si të jashtëzakonshme, dhe kur lexohet ai së bashku me Nenin 432, paragrafin 1 të KPP-së (kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër një vendimi gjyqësor të formës së prerë), nuk lë hapësirë për ta konsideruar që për këtë qëllim është e njëjtë sikur të kemi një aktgjykim apo aktvendim që ka marrë formë të prerë për shkak se më nuk i nënshtrohet ndonjë ankese

ose të kemi një aktgjykim apo aktvendim të formës së prerë që e pushon lëndën, procedurën. Nuk është njëjtë.

Mjetet e jashtëzakonshme juridike duhet përdorur vetëm kur të kemi një vendim gjyqësor të formës së prerë, ku procedura është kryer në formë të prerë. Në të vërtetë, edhe në rast ku kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është kundër procedurës gjyqësore e cila e ka paraprirë nxjerrjen e atij vendimi (vendimin gjyqësor të formës së prerë) vetëm (me theks të shtuar) pasi që procedura të jetë kryer në formë të prerë, mund të parashtrohet kërkesa – siç jepet në pjesën e fundit të paragrafit 1 të Nenit 432 të KPP-së.

Përrjashtimi nga ky parim është paraqitur qartë në paragrafin 4 të të njëjtit nen: kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të parashtrohet gjatë procedurës penale e cila nuk është kryer në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë që urdhërojnë apo vazhdojnë masën e paraburgimit.

Aty ku ka ndonjë dyshim për dallimin e adresuar më lartë (ndërmjet një vendimi që mori formën e prerë për shkak se nuk i nënshtrohet më ndonjë ankese dhe ndërmjet vendimit të formës së prerë të procedurës), kjo normë e caktuar në paragrafin 4 do ta qartësonte atë.

Interpretimi sistematik në lidhje me dy mjetet e jashtëzakonshme juridike të referuara në Nenin 418 të KPP-së, gjithashtu nuk lë dyshim që këto instrumente juridike e adresojnë procedurën që është pushuar, kryer, qoftë ajo e rihapjes së procedurës penale, qoftë e zbutjes së jashtëzakonshme të dënimit.

Gjithashtu, dhe tani në terma të interpretimit historik, ne mund ta shohim se në lidhje me legjislacionin procedural të Jugosllavisë, për nga doktrina qasja ishte e njëjtë (shih, për shembull, Branko Petric për Nenin e mëparshëm 416 në Komentarin e Ligjit për Procedurë Penale, 1986, botimi i 2<sup>-të</sup>. Përfundimisht, ne po e citojmë këtu paragrafin e 8<sup>-të</sup> të një komentari tjetër, “(8) [nëse] një vendim është në pikëpyetje duhet të jetë efektiv. Prokurori publik kompetent nuk mund ta anashkaloj juridiksionin apo mjetin e jashtëzakonshëm juridik, brenda afatit të ankesës apo para se të vendoset pas ushtrimit të ankesës nga i akuzuari,



dhe të parashtrojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Vendimi nga gjykata e shkallës së dytë me të cilin është anuluar aktgjykimi i shkallës së parë si rezultat i përcaktimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe lënda është kthyer në rigjykim, nuk mund ti nënshtrohet kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Ky është vetëm vendim formal efektiv me të cilin, në rastin aktual, një mënyrë veprimi përpara se të përcaktohet gjykata, dhe nga ana materiale nuk përfaqëson një vendim efektiv nga gjykata në kuptimin e procedurës penale. Procedura ende është në zhvillim e sipër, shkelja e ligjit ende mund të korrigjohet vetëm nga vet gjykata, ose do të korrigjohet me mjet të rregullt ligjor” (me theks të shtuar) – shih Momcilo Grubac dhe Tihomir Vasiljevic, Komentari i Ligjit për Procedurës Penale, 1982, botimi i 2<sup>-të</sup>, Administrimi Modern, Beograd.

### **Konkluzioni**

Pasi që kërkesa është e papranueshme, Gjukata do të përmbahet nga bërja e komenteve për meritat.

Nga sa u cek më sipër, u vendos si në dispozitiv.

**Gjyqtar Kryesues**

**Gjyqtari i EULEX-it Jorge Martins Ribeiro**

**Procesmbajtëse**

**Vjollca Kroci-Gerxhaliu**

**Anëtarët e Kolegjit**

**Gjyqtarja e EULEX-it**

**Elka Filcheva-Ermenkova**

**Gjyqtarja e Gjukatës Supreme**

**Nesrine Lushta**